

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË ALBPETROL SH.A. PATOS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Shoqërinë Albpetrol Sh.a. Patos, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën e veprimtarisë 01.08.2013 deri 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 134, datë 24.09.2015.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.200, me shkresën nr. 528/29, datë 05.01.2015 dërguar Ministrisë së Energjetikës dhe Industrisë si dhe Këshillit Mbikqyrës, me shkresën nr. 528/30, datë 26.09.2014, dërguar z. Endri Puka, Administrator i Shoqërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i zbatimit dhe realizimit të rekomandimeve të KLSH-së nga auditimi i mëparshëm, u konstatua që:

- Nuk është zbatuar masa organizative nr. 34, “Këshilli Mbikqyrës dhe Administratori i Shoqërisë “Albpetrol” SH.A. Patos, të analizojnë diferencën e inventarit në vitin 2012, në vlerën 268,716,149 lekë, e konstatuar gjatë procesit të inventarizimit në Qendrën e Prodhimit të Hidrokarbureve, Patos, në vlerën 17,109,447 lekë dhe në Qendrën Logjistike të Hidrokarbureve dhe Prodhimit të Rërës Bituminoze Patos në vlerën 251,606,702 lekë, si dhe të evidentojnë përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”.

Për këtë rekomandim Këshilli Mbikqyrës në mbledhjen e datës 09.01.2014, e ka trajtuar dhe ka vendosur që “Këshilli mbikëqyrës i kërkon shoqërisë informacion të detajuar për pikat që janë kompetencë e Këshillit Mbikëqyrës. Për sa i përket problemeve të konstatuar në administrim ngarkon shoqërinë të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.”

Po në mbledhjen e datës 06.03.2014 Këshilli Mbikëqyrës, i ka kërkuar shoqërisë që “të zbatojë me korrektësi legjislacionin në fuqi në lidhje me kompetencat për dhënie me qira të ambienteve dhe mjeteve”, si dhe “të marrë masa për zbatimin e të gjithave detyrave të lëna nga KLSH”.

Nga datat 09.01.2014 deri më datën 07.08.2014, për një periudhë 8-mujore, Administratori i shoqërisë, nuk është paraqitur më në asnjë mbledhje të Këshillit për ta informuar në lidhje me zbatimin e këtyre rekomandimeve të KLSH.

- Nuk është zbatuar masa organizative nr. 36, “Këshilli Mbikëqyrës të rishqyrtojë vendimin nr. 306, datë 31.10.2012, të Administratorit të Shoqërisë, për dhënie shpërblim në vlerën 176,870,000 lekë, me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë, në masën e një page mujore për të gjithë punonjësit e Albpetrolit, duke zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”.

Për këtë rekomandim Këshilli Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 09.01.2014, e ka trajtuar këtë çështje por nuk ka marrë vendim, duke vendosur që kjo çështje të diskutohet në mbledhjen tjetër.

Nga datat 09.01.2014 deri më datën 07.08.2014, për një periudhë 8-mujore, Administratori i shoqërisë, nuk është paraqitur më në asnjë mbledhje të Këshillit për ta informuar në lidhje me zbatimin e këtyre rekomandimeve të KLSH.

- Nuk është realizuar masa organizative nr. 5, “Shoqëria “Albpetrol” Sh.a. Patos, të marrë masa për të rinovuar kontratën kolektive të punës të punonjësve nr. 1655 prot, datë 30.05.2012, në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 173, deri në 30.06.2014. Realizimi i kësaj pike është në proces por me shumë devijime nga ana e kësaj shoqërie”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrë masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të cilat rezultuan ende të pazbatuara, si dhe të ndjekë me vëmendje të posaçme rekomandimet të cilat janë në procese gjyqësore, trajtuar më hollësisht në faqet 24-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrë masa për të rinovuar kontratën kolektive të punës të punonjësve nr. 1655 prot, datë 30.05.2012, në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 173, trajtuar më hollësisht në faqet 24-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2014

2. Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës, vendimet e marra prej tij dhe zbatimi, u konstatua që:

Vendimet e marra “Për miratimin e buxhetit” për vitin 2013, nuk janë miratuar te Aksioneri i vetëm, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë e Sipërmarrjes, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët e dhe Shoqëritë Tregtare” Kreu I “Asambleja e Përgjithshme” në nenin 135 “Të drejtat dhe detyrimet” pika 2, gërma “a”, VKM nr. 642, datë 11.05.2008, i ndryshuar, pika 8 dhe Udhëzimin nr. 318 datë 08.04.2009 “Emërimi, funksionimi dhe shpërblimin e Këshillave Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 7.

Me vendimin të Këshillit Mbikëqyrës nr. 4 datë 07.10.2013 “Për shtesë në strukturë “drejtor ekzekutiv”, sipas kërkesës nr. 3178 datë 03.10.2013, të bërë nga Administratori për shtesë në strukturë, nuk është shoqëruar me relacion përkatës mbi detyrat e kompetencat e kësaj shtese, si dhe me ndryshimet përkatëse në rregulloren e brendshme të funksionimit të kësaj shoqërie.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori, të miratojnë programin ekonomik-financiar (buxhetin vjetor) dhe ndryshimet e tij gjatë vitit, me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, dhe nëse është parashikuar në statut dhe ligjet specifike, të miratohet edhe nga Aksioneri i vetëm, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë e Sipërmarrjes, si dhe të marrin masa për zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, duke bërë analiza periodike dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar, trajtuar më hollësisht në faqet 37-40, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori, të marrin masa që në rregulloren e brendshme të funksionimit të kësaj shoqërie, të jenë të përcaktuar detyrat e kompetencat e drejtorit ekzekutiv, trajtuar më hollësisht në faqet 37-40, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2014

3. Nga auditimi mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore, u konstatua që:

Për periudhën e audituar struktura organizative e shoqërisë ka pësuar ndryshime në rritje të numrit mesatar të punonjësve me plus 219 punonjës (nga 1868 në 2087 punonjës), me efekt financiar në dëm të buxhetit të shoqërisë deri më 31.07.2014 në vlerën 74,954,502 lekë.

Kjo shtesë është në kundërshtim me VKM nr. 106 datë 01.02.2012 “Për trajtimin e punonjësve që dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit të shoqërisë “Albpetrol” Sh.a. Patos”, Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nr. 12 datë 03.09.2013 “Për zbatimin e VKM nr. 106 datë 01.02.2012 “Për trajtimin e punonjësve që dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit të shoqërisë “Albpetrol” Sh.a. Patos”, si dhe me vendimin e Këshillit mbikëqyrës nr. 5 datë 13.11.2013 “Për miratimin e strukturës së shoqërisë “Albpetrol” Sh.a. dhe numrit të punonjësve të shoqërisë për 1868 punonjës. Kjo shtesë e fuqisë punëtore është e pa justifikuar me rritjen e të ardhurave financiare.

Për periudhën e audituar struktura organizative e shoqërisë ka pësuar ndryshime në rritje të numrit të administratës me plus 21 punonjës (nga 129 në 150), si dhe janë marrë 30 punonjës administrate me kontratë të përkohshme, me një me efekt financiar në dëm të buxhetit të shoqërisë deri më 31.07.2014 në vlerën 9,974,376 lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të rishqyrtohet nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë “Albpetrol” Sh.a. Patos, shtesa e fuqisë punëtore dhe e administratës me 240 punonjës në vlerën 84,928,878 lekë, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës, në zbatim të VKM Nr. 106 datë 01.02.2012 “Për trajtimin e punonjësve që dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit të shoqërisë “Albpetrol” Sh.a. Patos”, Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Nr. 12 datë 03.09.2013 “Për zbatimin e VKM Nr. 106 datë 01.02.2012 “Për trajtimin e punonjësve që dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit të shoqërisë “Albpetrol” Sh.a. Patos”, si dhe vendimit të Këshillit mbikëqyrës nr. 5, datë 13.11.2013 “Për miratimin e strukturës së shoqërisë “Albpetrol” Sh.a.

Brenda datës 31.12.2014

4. Nga auditimi mbi auditimin e gjendjes së debitorëve dhe kreditorëve, si dhe zbatimin e ligjshmërisë për inventarizimin e pasurisë, u konstatua që:

Gjendja debitore dhe kreditore në fund të vitit 2013 është në shifra shqetësuese për shoqërinë dhe nga organet drejtuese të saj, nuk është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi, si dhe nuk janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre.

Konkretisht gjendja debitore është në vlerën 13.665.398,502 lekë, ndërsa gjendja kreditore në vlerën 7.282.266,941 lekë. Duke ju referuar të ardhurave dhe shpenzimeve, gjendja debitore zë respektivisht 169 % të të ardhurave dhe gjendja kreditore zë 194 % të shpenzimeve.

Në gjendjen debitore përsa i përket detyrimeve në fund të vitit 2013, sipas kontabilitetit pasqyrohet edhe shuma 247,774,887 lekë, që përfaqëson vleftën e godinave të banimit të ndërtuar në vite, por që nga ana e administratës, nuk është mbyllur me privatizimin e shitjen e

tyre punonjësve, pra në kontabilitet këto objekte janë pronë e shoqërisë, ndërsa në fakt posedohen fizikisht nga persona të tretë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës, Administratori, Drejtorja Ekonomike, të analizojnë gjendjen debitore dhe kreditore më datë 31.12.2013, si dhe të marrë masat e nevojshme për reduktimin e tyre, trajtuar më hollësisht në faqet 49-50, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.11.2014

Të merren masa nga Shoqëria “Albpetrol” SH.A. Patos, që në gjendjen debitore të pasqyrohet detyrimi që bankat i kanë Shoqërisë “Albpetrol” SH.A. Patos, për subjektet që likuidimin e naftës bruto të blerë nga shoqëria “Albpetrol”, e kanë likuiduar me Letër Crediti, si dhe të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve, trajtuar më hollësisht në faqet 24-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

5. Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë në veprimet e arkës dhe bankës në lekë dhe valutë, si dhe blerjet me vlera të vogla, u konstatua që:

Me urdhërpagesat datë 15.12.2013 dhe 13.05.2014, drejtuar Bankës Credins, Administratorit i shoqërisë “Albpetrol”, i ka dhënë në formën e huadhënies shoqërisë Albminiera Sh.a. vlerën 12.500,000 lekë dhe Petrolalba Sh.a. vlerën prej 25.000,000 lekë.

Shoqëritë Petrolalba Sh.a. dhe Albminiera Sh.a., në bazë të akt-marrëveshjes së lidhur midis palëve, huat e marra si më sipër, duhej ti kthenin brenda datës 30.06.2014. Deri më datë 07.08.2014 (datë në të cilën ka përfunduar auditimi), nga ana e këtyre shoqërive nuk janë likuiduar akoma këto detyrime, duke i shkaktuar shoqërisë Albpetrol Sh.a. Patos, një efekt financiar negativ (rritje e kostos së borxhit) për vlerën 302.152,60 lekë.

Me urdhër pagesat e bankës për datat 04.11.2013 dhe 06.03.2014 nga shoqërisë Albpetrol Sh.a. Patos, janë paguar gjoba e kamatëvonesa Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Njësisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, shuma prej 7.432,518 lekë dhe nga ana e titullarëve të kësaj shoqërie nuk ka dalë akoma përgjegjësia ndaj shkaktarëve.

Për periudhën objekt auditimi, është shpenzuar karburant për mjetet e shoqërisë në sasinë 49.060 litra me vlerë 9.699,093 lekë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit (gjatë auditimit dhe me observacione), nuk vërtetohet plotësisht kryerja e këtij shpenzimi, pasi një pjesë e dokumentacionit justifikues bazë është me mangësi. Konkretisht nuk ka fletë-udhëtime, urdhër punë, aktet teknike për përcaktimin e normativës së harxhimit të karburantit për çdo automjet, si dhe kartelat përkatëse të tyre, rakordime mujore dhe vjetore për sasinë e naftës së tërhequr nga magazina me harxhimin në fakt të sasisë së tërhequr për çdo drejtues mjeti etj. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, SKK 2 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, duke i krijuar në këtë mënyrë një efekt financiar negativ në vlerën 9,699,093 lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë “Albpetrol” SH.A. Patos, të shqyrtohet efekti financiar negativ për vlerën 302.152,60 lekë, nga moskthimi në afat i huadhënies për shoqërinë Albminiera Sh.a., shuma prej 12.500,000 lekë dhe Petrolalba Sh.a., në vlerën 25.000,000 lekë

dhe vlera 7.432,518 lekë që përfaqëson gjoba e kamat vonesa Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Njësisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës, në zbatim të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, trajtuar më hollësisht në faqet 50-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2014

Nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë “Albpetrol” SH.A. Patos, të shqyrtohet efekti financiar negativ për vlerën 9.699,093 lekë, për të cilin nuk vërtetohet plotësisht kryerja e këtij shpenzimi, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, trajtuar më hollësisht në faqet 50-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2014

6. Nga auditimi mbi organizimin dhe mbajtjen e evidencave kontabël, respektimin e afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë si dhe dërgimin dhe miratimin e tij në organet e vartësisë, u konstatua që:

Qendra e Administrimit Shitjes Naftës dhe Gazit Patos (QASHNG), përdor për regjistrimet kontabël të vitit 2014, programin Microsoft Excel, program të cilin ka akses vetëm një operatore dhe vetëm nga një kompjuter. Programi “Microsoft Excel” me të cilin operon QASHNG Patos, nuk të ndalon mundësinë e ndryshimit të veprimeve kontabël të periudhave të mëparshme, duke lënë të hapur mundësinë për ndryshime të këtyre veprimeve, në mënyrë abuzive ose të paqëllimshme. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 3, pika 9, e cila në mënyrë eksplicite përcakton se: “Bartësi informatik” është çdo dokument i evidencës mbështetëse, i autorizuar nga organet përkatëse, i shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë”.

QASHNG për blerjet e naftës nga shoqëritë koncensionare, për çdo muaj, përdor kursin e datës së veprimit të parë dhe jo kursin e ditës, ndërsa për shitjet e naftës përdor kursin e datës së shitjes, në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 9 “Respektimi i standardeve kontabël”, SKK 12 “Efekti e ndryshimit në kurset e këmbimit”, pika 9 e cila në mënyrë eksplicite përcakton se: “Data e transaksionit është data kur transaksioni fillimisht plotëson kushtet për njohjen fillestare, në përputhje me SKK-të. Për arsye praktike, shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është i përafërt me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, p.sh. një kurs mesatar i një jave ose një muaji mund të përdoret për të gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në secilën prej monedhave të përdorura. Por, nëse gjatë periudhës ka luhajtje të konsiderueshme të kursit të këmbimit, përdorimi i kursit mesatar nuk është i këshillueshëm”;
- Ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe
- Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

QASHNG ka rënduar llogarinë “Mallra për Rishitje” për vlerën 825.747,09 lekë dhe ka llogaritur e paguar detyrimin për TVSH më tepër në vlerën 165.149,42. Ndërsa për periudhën Janar–Qershor 2014, QASHNG Patos, ka paraqitur më pak llogarinë “Mallra për Rishitje” për vlerën 1.239.484,17 lekë dhe ka llogaritur e paguar detyrimin për TVSH më pak në vlerën 247.896,83 lekë (në mënyrë të detajuar paraqiten në Aneksi nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

QASHNG ka paraqitur në pasqyrat financiare të viti 2013, në grupin e Aktiveve Financiare Afatshkurtra, zërin “Instrumente të tjera borxhi mbi 10 vite”, në vlerën 444.087,290 lekë. Kjo vlerë përfaqëson humbjet e naftës për vitin 2013 të denoncuara në organet kompetente, si dhe humbjet e denoncuara për tubacionet e vjedhura. Gjatë vitit kjo vlerë është mbajtur në llogarinë 471 “Llogari në pritje”, ndërsa në pasqyrat financiare është fshehur në zërin “Instrumente të tjera borxhi mbi 10 vite”, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 6 “Evidenca mbështetëse”.

QASHNG ka paraqitur në pasqyrat financiare të viti 2013, zërin “Provizione për zhvlerësim të kërkesave të arkëtueshme”, në vlerën 38,833,280 lekë. Nga auditimi i kartelës së kësaj llogarie, u konstatua se kjo llogari është çelur me vlerën 38.819,737 lekë, ndërsa gjatë vitit ushtrimor, nuk ka patur asnjë lëvizje kreditore ose debitore. Shtimi në vlerën 13,543 lekë, është i pajustificuar me veprime kontabël. Për më tepër nga QASHNG Patos, për këtë llogari, nuk disponohej asnjë dokumentacion, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 6 “Evidenca mbështetëse”.

QASHNG Patos, për naftën që blen nga Qendrat e brendshme, e blen me çmimin fiks 18,634 lekë/ton, ndërsa naftën që merr nga kompanitë koncensionare e blen në bazë të çmimit të bursës. Për përcaktimin e vlerës së inventarit të mbetur dhe kostos së inventarit të shitur, QASHNG Patos, shumëzon sasinë e mbetur në fund të periudhës me çmimin e furnizimit të brendshëm 18,634 lekë/ton, dhe jo metodën FIFO (hyrje e parë dalje e parë) ose mesataren e ponderuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Neni 9 “Respektimi i standardeve kontabël”, SKK 4 “Inventarët”, pika 15.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Administratori i shoqërisë dhe Drejtoria Ekonomike, të merren masa për përshtatjen e programit kompjuterik në Qendrën e Administrimit Shitjes Naftës dhe Gazit Patos (QASHNG), në përputhje me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 3, pika 9, trajtuar më hollësisht në faqet 40-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

Nga Administratori i shoqërisë, Drejtoria Ekonomike dhe QASHNG Patos, të merren masa që për transaksionet financiare të kryera në valutë, konvertimi në lekë gjatë vitit të kryhet me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, në përputhje me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 9 “Respektimi i standardeve kontabël”, SKK 12 “Efekti e ndryshimit në kurset e këmbimit”, pika 9, trajtuar më hollësisht në faqet 40-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

Nga Administratori i shoqërisë, Drejtoria Ekonomike dhe QASHNG Patos, të merren masa për sistemimin e llogarisë “Mallra për Rishitje” dhe detyrimit të tvsh, në përputhje me Ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, trajtuar më hollësisht në faqet 40-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2014

Nga Administratori i shoqërisë, Drejtoria Ekonomike dhe QASHNG Patos, të merren masa për paraqitjen dhe kontabilizimin e saktë në pasqyrat financiare të vlerës 444,087,290 lekë, në zbatim të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, vlerë e cila përfaqëson humbjet dhe vjedhjet e naftës, humbjet dhe dëmtimet në tubacion, e pasqyruar në llogarinë 471 “Llogari në pritje”, trajtuar më hollësisht në faqet 40-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2014

Nga Drejtoria e Financës së Albpetrol Sh.a., Administratori dhe QASHNG Patos, të merren masa për paraqitjen dhe kontabilizimin e saktë të zërit “Provizione për zhvlerësim të kërkesave të arkëtueshme”, në vlerën 38.833,280 lekë, në përputhje me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 6 “Evidenca mbështetëse”, trajtuar më hollësisht në faqet 40-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 3.12.2014

7. Nga auditimi në Qendrën e Administrimit dhe Shitjes së Naftës dhe Gazit Patos, u konstatua që:

Bilanci i naftës bruto për periudhën 01.10.2013-31.12.2013, ka diferencë në sasinë 4.938,1 ton naftë bruto me vlerë 92.016.555,40 lekë, si dhe për periudhën 01.01.2014-30.06.2014 ka diferencë në sasinë 465.48 ton naftë bruto me vlerë 8.673,754 lekë. Shuma totale e diferencës në bilancin e naftës bruto për vitin 2013 dhe 2014 është në sasinë 5.403,58 ton naftë bruto me vlerë 100.690.309,4 lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të shqyrtohet nga Këshilli Mbikëqyrës, Administratori Shoqërisë dhe Këshilli Tekniko Shkencor i Shoqërisë “Albpetrol” Sh.a. Patos, diferenca e naftës bruto e konstatuar në QASHNG Patos, në bilancin e periudhës 01.10-31.12. 2013 në sasinë 4,938.1 ton me vlerë 92.016.555,40 lekë dhe në bilancin e periudhës për periudhën 01.01-30.06.2014 në sasinë 465.48 ton me vlerë 8,673,754 lekë. Të evidentohen përgjegjësit, si dhe të merret vendimi përkatës për zhdëmtimin material, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, trajtuar më hollësisht në faqet 14-156, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2014

8. Nga auditimi mbi zbatimin e procedurave ligjore për dhënien me qira të ambienteve si dhe zbatimi i kushteve të kontratës, u konstatua që:

Nga Administratori i Shoqërisë dhe Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës, administrimi i aseteve në pronësi të Shoqërisë është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 11, pika 4,5 dhe neni 12 pika f dhe g, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, pikat 93 e 94, Rregulloren e Brendshme, Kreu II pikat (F/11,13,16) dhe (H/5,7,11,12,17).

Konkretisht nuk janë nxjerrë aktet administrative përkatëse, për kërkimin në rrugë ligjore, si dhe nuk janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme në të gjitha shkallët e gjyqimit për kthimin e aseteve, si dhe pagesën e vlerave të tyre në rastet e humbjeve dhe dëmtimeve, pasi ka:

- Sipërfaqe të zëna nga të tretë që nga vitet 1995, pa leje në 4 raste në një sipërfaqe prej 18,893.99 m2 dhe ndërtesa të zëna pa leje që nga viti 1991 dhe nuk paguajnë qira në 14 raste, prona këto pjesë e inventarit të aktiveve (me vlerë kontabël prej 56,850,248 lekë,) për të cilat nuk është bërë asnjë hap për rikthimin e tyre dhe regjistrimin e tyre pranë ZRRPP në pronësi të Albpetrolit.
- Aktivitet afatgjatë (objekte e makineri) të dhëna me qira dhe që nuk janë kthyer pas përfundimit të kontratës dhe vazhdojnë të shfrytëzohen nga ish-kontraktuesit, në 8 raste të dhënies së makinerive me qira, (me vlerë fillestare kontabël prej 16,087,250 lekë) dhe në 9 raste të dhënies së ndërtesave me qira.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës, Administratori Shoqërisë dhe Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës, të merren masa për ndjekjen procedurave administrative për kthimin e aseteve, të:

- sipërfaqeve, truall dhe ndërtesave të zëna pa leje që nga viti 1991 dhe që nuk paguajnë qira,
- 8 rasteve të dhënies me qira të makinerive dhe të pakthyerat të bëhet vlerësimi i tyre dhe të kërkohet kthimi apo zhdëmtimi i tyre,
- 19 rasteve të marrjes me qira të ndërtesave, të cilat u ka mbaruar afati i kontratave, nuk janë liruar dhe vazhdojnë të shfrytëzohen nga ish-kontraktuesit, të kërkohet lirimi i menjëhershëm i tyre.

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë “Albpetrol” SH.A. Patos, të shqyrtohen detyrimet jokontraktuale të lindura nga shfrytëzimi i aseteve pas përfundimit të kontratave deri në momentin aktual, si dhe të merret vendimi përkatës.

Trajtuar më hollësisht në faqet 135-140, të Raportit Përfundimtar të Auditimit

Brenda datës 31.12.2014

Brenda datës 31.12.2014

9. Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, u konstatua që:

Në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin, përsa i përket komponentit të mjedisit të kontrollit u konstatua se në Rregulloren e Funksionimit të Brendshëm të administratës së Albpetrol sha kompetencat të cilat bazuar në Ligjin nr. 9729, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, i takojnë vetëm Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të Albpetrol sha, i janë dhënë edhe Drejtorisë së Marrëveshjeve dhe Hidrokarbureve, ku referuar rregullores së brendshme të shoqërisë Albpetrol sha përcaktohet që kjo drejtori “organizon grupe kontrolli dhe auditimi për aspekte të ndryshme të aktivitetit

hidrokarbur që kryhen nga kontraktorët dhe informon me shkrim Administratorin e shoqërisë”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës, Administratori Shoqërisë dhe Drejtoria e Auditit të Brendshëm, të rishikohet Rregullorja organizimit dhe funksionimit të brendshëm të shoqërisë, dhe të bëhen rregullimet e nevojshme në lidhje me përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve sipas drejtorive deri në nivel specialisti. Të përfshihet në objektin e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, auditimi në Shoqëritë koncensionare që janë objekt i marrëveshjeve hidrokarbure dhe të mos pengohet në asnjë rast, si dhe të përcaktohen detyra dhe përgjegjësitë në lidhje me të. Të bëhet pjesë e Rregullores zbatimi i parimeve të kodit etik si dhe rastet e rregullat për t'u zbatuar për shmangien e konfliktit të interesit, trajtuar më hollësisht në faqet 140-148, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

10. Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Auditimit, u konstatua që:

- Në strukturën e AB për vitin 2014 janë rekrutuar 4 specialist të auditit, që nuk janë të pajisur me çertifikatën “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”.
- Nuk është hartuar manuali specifik dhe karta e Auditit të Brendshëm të “Albpetrol” Sh.a”.
- Nuk janë dërguar në NJQHAB e Ministrisë së Financave planet strategjike dhe vjetore.
- Nuk është realizuar plani vjetor i auditimit sipas llojeve dhe objekteve të përcaktuara.
- Nuk janë dërguar në NJQHAB e Ministrisë së Financave, të shoqëruara këto me evidencat e raportimit për vitin 2013 në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës.
- Nuk është realizuar për vitin 2013 një mision auditimi për zbatim rekomandimesh për subjektet e audituara, të përcaktuara këto sipas prioriteteve dhe afateve kohore.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, ndryshuar me Ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010, Manualin e Auditimit të Brendshëm (MAB), të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 69, datë 29.09.2010 me UMF nr. 12 datë 5.6.2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës, Administratori Shoqërisë dhe Drejtoria e Auditit të Brendshëm, të merren masa për hartimin e manualit specifik dhe kartës së Auditit të Brendshëm të “Albpetrol Sh.a” zbatimin e standardeve të auditimit në organizimin, funksionimin, rekrutimin e stafit dhe në të gjitha fazat e procesit të auditimit, në zbatim të Ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe UMF nr. 12 datë 5.6.2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”, trajtuar më hollësisht në faqet 140-148, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2014

11. Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë në fushën e prokurimeve, efektivitetin e investimeve, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua që:

Autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar procedurën e hapur në të gjitha kontratat, duke përdorur në disa raste procedurën me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës, pa ekzistuar plotësisht kushtet dhe rrethana e veçanta të përcaktuara në nenin 33 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) - “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit” dhe kreun IV pika 5 e Rregullat e Prokurimit Publik (RRPP) - Procedura me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës.

Në 7 raste studimi i vlerës së kontratës nuk është plotësisht i saktë, pasi në përcaktimin e fondit limit nuk janë harmonizuar metodat e vendosura në aktet ligjore e nënligjore të prokurimeve, si çmimet e botuara nga INSTAT-i, çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, është mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga Autoriteti Kontraktor janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu II, pika 2/c,ç.

Në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim. Ky veprim bie në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

Në 7 raste nga njësia e prokurimit, në kërkesat e veçanta të kualifikimit, për kontratat e mallrave, nuk u janë kërkuar operatorëve ekonomik, dëshmitë e origjinalitetit të mostrave, si dhe dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucionet e autorizuara që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikime teknike, veprim ky në kundërshtim me germën “i”, pika 3, “Informacione të veçanta”, kreu III-të të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik të ndryshuar”.

Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për shkaqet subjektive që vërehen në procedurat e anuluar, në kundërshtim me LPP dhe RRPP. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit. Vendimi për anulimin e procedurës së prokurimit duhet publikuar (botuar) brenda 10 ditëve. Ky konstatim bazohet në numrin e lartë të anulimit të procedurave të zhvilluara, si dhe emrat e njëjtë të fituesve të kontratave të furnizimeve apo të punëve për çdo vit.

Mbas lidhjes të kontratave me subjektin fitues, nuk është bërë çlirimi i garancisë të ofertës të ofertuesve pjesëmarrës në tender, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 49, pika 2.

Në 7 raste nuk është bërë ndarja e detyrave midis zyrtarëve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së fituesit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu V-të, “Zhvillimi i procedurave”, pika 1, germa “a”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Për një përdorim me efikasitet të fondeve publike të argumentohet domosdoshmëria e kryerjes së prokurimit me leverdinë ekonomike dhe volumet efektive të punëve që do të kryhen;

- Autoriteti Kontraktor, të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.
 - Nga Administratori i shoqërisë t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste konstatohet jo korrekt.
 - Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejt kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organe kompetente.
 - Për të përcaktuar përgjegjësinë individuale, të bëhet ndarja e detyrave ndërmjet anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe të miratohet nga titullari i Autoritetit Kontraktor.
- Trajtuar më hollësisht në faqet 57-104, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

Në shpenzimet e programuara për vitin 2014, me emërtim “Shpenzime variabël” me analizë “Sigurim jete, sigurim i aksidenteve të punës dhe kontroll mjekësor” është propozuar, miratuar dhe prokuruar fondi prej 60,000,000 lekë për këtë zë shpenzimi, ku futja në këtë prokurim i zërit të shërbimit “Sigurim i aksidenteve personale” dhe “Sigurim i humbjes së jetës”, është në kundërshtim me nenin 103, pika 4, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë; me Ligjin nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet”, i ndryshuar; VKM nr. 109, datë 30.07.2008 “Për sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtaritë minerare nga aksidentet në punë”; VKM nr. 742, datë 06.11.2003 “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr. 692, datë 13.12.2001 të Këshillit të Ministrave “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”; Kontrata kolektive të punës, neni 3, pika 4, neni 12, pika 3, shkronja “d”, neni 16, pika 6. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi Këshillin Mbikëqyrës.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës, Administratori Shoqërisë dhe Drejtoria Ekonomike të merren masa që në të ardhmen në shpenzimet për sigurim jete, sigurim i aksidenteve të punës etj, të kryhen për atë kategori punonjësish, që është përcaktuar në dispozitat përkatëse ligjore. Për këtë të ngrihen grupe të veçanta pune me teknike e mjeke, të cilët të përcaktojnë se kush kategori punonjësish duhet të sigurohen me qellim, shmangien e kryerjes se shpenzimeve të tepërta. Duke qene se kontrata e nënshkruar tashme ka një vlere të konsiderueshme ekonomike, shoqëria të marre masa që nëpërmjet grupit të Kolaudimit, por edhe nëpërmjet strukturave të tjera të shoqërisë të ndjek me rigorozitet kryerjen e të gjitha shërbimeve të parashikuara në kontratë, me qellim evidentimin e saktë të këtij shpenzimi, trajtuar më hollësisht në faqet 57-104, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

12. Nga auditimi mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e marrëveshjeve të hidrokarbureve të lidhura me kompanitë e huaja që operojnë në sektorin e kërkimit dhe nxjerrjes së naftës, u konstatua që:

Kompanitë konçensionare me të cilat shoqëria “Albpetrol” SH.A. Patos, ka lidhur marrëveshje për prodhimin dhe zhvillimin e hidrokarbureve në vendburimet ekzistuese, nuk i kanë dorëzuar në kohë shoqërisë “Albpetrol” Sh.a. detyrimin e prodhimit paraekzistues (PPE)

dhe pjesa e “Albpetrol” Sh.a. (PPA). Detyrimi në total që kompanitë koncensionare i kanë shoqërisë “Albpetrol” Sh.a. në datën 30.06.2014 është në sasinë 57,118.07 ton naftë bruto, e konvertuar në lekë është në vlerën 2,502,342,646.70 lekë dhe gaz në sasinë 9,815,179 Nm³, me vlerë 343,531,264 lekë.

Konvertimi i naftës bruto është përlllogaritur me vlerën e produktit të gatshëm që pasqyrohet në kontabilitetin (bilancin) e shoqërisë Albpetrol.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Shoqëria “Albpetrol” SH.A. Patos duhet të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore, për të përfituar sasinë 57,118.07 ton naftë bruto dhe kontesatë dhe e sasisë 9,815,179 MNm³ gaz, e prodhimit të padorëzuar shoqërisë “Albpetrol” SH.A. Patos deri më 30.06.2014, nga kompanitë e huaja që operojnë në bazë të Marrëveshjeve Hidrokarbureve, si pjesë e prodhimit paraekzistues (PPE) dhe pjesën e Albpetrolit (PPA), me vlerë totale 2,848,783,224 lekë. Konvertimi i naftës bruto është përlllogaritur me vlerën e produktit të gatshëm që pasqyrohet në kontabilitetin (bilancin) e shoqërisë Albpetrol.

Në raport me detyrimin progresiv

Kompania “██████████” ka zbritur nga nafta e prodhuar, sasinë e holluesit të përdorur. Si pasojë e kësaj zbritjeje:

- Kompania nuk i ka dorëzuar shoqërisë “Albpetrol” Sh.a. Fier më 31.12.2013 sasinë 23,004.35 ton naftë bruto pjesë e PPE-së & PPA-së me vlerë 1,007,820,573.50 lekë, ndërsa deri më 30.06.2014 sasinë 7,188.70 ton naftë bruto me vlerë 314,936,947.00 lekë.

Kjo zbritje e holluesit është në kundërshtim me pikën 3.5.1,3 të marrëveshjes së firmosur nga palët në datën 19.06.2004 dhe të ratifikuar nga Këshilli i Ministrave me VKM nr. 477 datë 16.07.2004 dhe datë efektive 20.07.2004.

- Është ndikuar në faktorin R. Ecuria e këtij faktori ka lidhje direkt me përfitimet e Shtetit Shqiptar. Kur $R \geq 1$, fitimi ndahet 50% për ██████████ dhe 50% për Shtetin Shqiptar.

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguara me shkresën nr. 503/10, datë 06.09.2013, shoqëria “Albpetrol” Sh.a., kompanisë “██████████”, i është njoftuar pavlefshmëria e pjeshme e marrëveshjes “Mbi procedurat për marrjen në natyrë të PPE-së dhe PPA-së”, përkatësisht me shkresën tonë nr. 5101 Prot., datë 17.12.2013, me lëndë “Për anulimin e pjeshëm të marrëveshjes për marrjen e PPE-së & PPA-së në Natyrë”. Deri më datë 07.08.2014 (datë në cilën përfundojë auditimi), “Albpetrol” Sh.a. ndodhet në fazën ku po negocion Termat e Referencës, (kohë shumë e gjatë nga konstatimi dhe rekomandimi i KLSH-së), të cilat do t’i dërgohen ekspertit të caktuar sipas nenit 19.10 të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Patos-Marinëz” për zgjidhje të konfliktit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë, të vazhdojnë procedurat ligjore, për shfuqizimin pjesor të marrëveshjes të datës 16.09.2013, të lidhur ndërmjet kompanisë “██████████” dhe shoqërisë “Albpetrol” Sh.a, për përdorimin e holluesit për arsye se Aktmarrëveshja ka dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit dhe ka favorizuar kompaninë “██████████”, me vlerë të përlllogaritur 9,484,216.5 USD, trajtuar më hollësisht në faqet 104-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, e cila për shoqërinë Albpetrol Sha përbën dëm ekonomik.

Nga Administratori i shoqërisë z. [REDAKTUAR] është lidhur aktmarrëveshja e datës 28.02.2014, me kompaninë "[REDAKTUAR]", përfaqësuar nga Z. [REDAKTUAR]. Aktmarrëveshje e cila ka dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit dhe ka favorizuar kompaninë "[REDAKTUAR]", me vlerë minimalisht të përlllogaritur në 1,416,443 USD me argumentet si më poshtë:

Aktmarrëveshja, për kthimin nga kompania "[REDAKTUAR]", të detyrimit të PPE (prodhimit paraekzistues), nga njësi fizike ton, në kthim në vlerë, me çmim të llogaritur nga vetë "Albpetrol" Sh.a, është në kundërshtim me;

- nenin 3, pika 3.5.1 të marrëveshjeve "Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve", ku në mënyrë eksplicite citohet "Çdo pus i "Albpetrol" Sh.a. në zonën e kontratës mund të merret nga kontraktori në përputhje me procedurën e marrjes në dorëzim në Aneksin nr. 1. Kur kontraktori merr puse të "Albpetrol" Sh.a, Kontraktori do ti dorëzojë në natyrë "Albpetrol" Sh.a, Prodhimin e gjykuar të puseve të tilla në muajt në vazhdim të marrjes...".
- nenin 26.5 ku në mënyrë eksplicite citohet "Kjo marrëveshje është ligjore dhe detyruese në dhe prej ditës efektive".
- nenin 1, pika 1/6 e cila në mënyrë eksplicite citon "Marrëveshje, do të thotë kjo marrëveshje hidrokarbure së bashku me anekset, si ç`mund të amendohet herë pas here me rënie dakort të palëve dhe aprovim të Këshillit të Ministrave, për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në zonën e kontratës".

Kjo marrëveshje, është kryer duke mos zbatuar paraprakisht procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të këtyre ndryshimeve, nga Këshilli Mbikëqyrës, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Këshilli i Ministrave.

Vlera 73,96 USD/Barelë, është vendosur në kundërshtim me;

- Aktit normativ i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 16.6.2010 "Për një shtesë në Ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)", të ndryshuar, Ligjin nr. 9874, datë 14.2.2008 "Për ankandin publik", të ndryshuar.
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik", i ndryshuar.
- Urdhrin nr. 83 datë 10.2.2012 të Ministrit "Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure", i ndryshuar me urdhrin nr. 635, datë 13.09.2012 "Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure (naftë bruto). Në këtë akt marrëveshje ndër të tjera nuk është marrë në konsideratë dhe është shkelur fakti dhe detyrimi në urdhrin nr. 83 të Ministrit.
- Pika 5, e cila në mënyrë eksplicite citon "Shitja e produkteve hidrokarbure (naftës bruto) për tregun vendas me qëllim përpunimin e tyre dhe/ose për eksport, do të bëhet sipas çmimit të Bursës Ndërkombëtare për hidrokarburet (Bursës Ndërkombëtare Brent, BRENT/KOFICENT KORREKTIMI)".
- Pika 6. "Çmimi/njësi minimal fillestar i shitjes përcaktohet nga autoriteti shitës, nëpërmjet çmimit të produktit të publikuar në bursë për Brentin, në momentin e përlllogaritjes, duke marrë në konsideratë koeficientin e konvertimit të këtij çmimi sipas cilësisë së produktit të prodhuar, dhe përcaktohet gjithmonë përpara fillimit të procedurës së shitjes. Në çdo rast, çmimi/njësi minimal fillestar i shitjes duhet të jetë më i lartë se çmimi i shitjes i programuar nga "Albpetrol" Sh.a. për vitin përkatës".
- Pika 7 e cila citon "Për nxjerrjen e të dhënave sipas pikës 6, krijohet grup ekspertësh të fushës të miratuar nga Ministri. Grupi i ekspertëve përbëhet nga specialist 1 specialist

nga MEI, 2 specialist nga Albpetroli, 1 Specialist IQT (Inspektorati Qendror teknik) dhe 1 specialist nga AKBN”.

Mos përfshirja i gjithë detyrimit që kompania “██████████” ka ndaj shoqërisë “Albpetrol” Sh.a. për PPE dhe PPA, me një diferencë 10,216.5 ton naftë bruto, si dhe të sasisë 8,959,318.5 Nm³ e në vlerën 313, 576,147.50 lekë. (8,959,318.5 N m³ :1000x 35,000 lekë/ N m³ =313, 576,147.50 lekë)

Më datën 28.02.2014, që është lidhur marrëveshja ndërmjet kompanisë “██████████”, përfaqësuar nga Arian Tartari dhe shoqërisë “Albpetrol” Sh.a. përfaqësuar nga Endri Puka, detyrimi i në total kompanisë “██████████”, datë 31.12.2013, sipas kësaj aktmarrëveshje është në sasinë 51,181.25 ton naftë bruto. Edhe pse është njohur, dhe pranuar detyrimi që kompania “██████████”, ka ndaj “Albpetrol” Sh.a, është rënë dakort që vetëm sasia 40,964,78 ton të kthehet e konvertuar në vlerë, duke mos përfshirë nga ky detyrim sasinë 10,216.5 ton naftë bruto, e cila ka të bëjë me gjendjen e naftë bruto 5,604.7 ton (dorëzuar me dorëzimin e puseve) dhe 4,611.8 ton forcë madhore (ndodhur) në vitin 2011, pretendim i Kompanisë “██████████”, se nga ndërprerja e furnizimit me energji elektrike nga ÇEZ në tremujorin e parë 2011, kësaj kompanie i është krijuar një humbje PPE dhe PPA në sasinë 4,611.8 ton naftë bruto. Theksojmë se sipas kësaj marrëveshje Shoqëria Albpetrol, kishte detyrimin që nëpërmjet ÇEZ, të furnizonte Kompaninë “██████████” me energji elektrike.

Në marrëveshjen e sipërpërmendur nuk përcaktohet, se mbi çfarë dokumentacioni është marrë në konsideratë, dhe cila është struktura që ka pranuar dhe miratuar sasinë e efektit të kësaj forcë madhore 4,611.8 ton naftë bruto. (Këshilli Teknik Shkencor, Administratori, Këshilli Mbikëqyrës, AKBN etj).

Administratori i shoqërisë Albpetrol ██████████ ka lidhur marrëveshje të datës 04.04.2014 me kompaninë “██████████”, për kthimin fizik të sasisë sasisë 11,011 ton naftë bruto në vendburimet të “Ballsh-Hekali”.

Marrëveshja e datës 04.04.2014 e lidhur ndërmjet kompanisë “██████████”, përfaqësuar nga ██████████ dhe shoqërisë “Albpetrol” Sh.a. përfaqësuar nga z. ██████████, “Për likuidimin e detyrimit në naftë bruto për vendburimin e Ballsh-Hekalit, lëvruar nga “██████████” tek “Albpetrol”Sh.a., mbi detyrimin kontraktual, nga data efektive deri me 31.12.2013 që Albpetrol Sh.a. i detyrohet “██████████”, në sasinë 11,011 ton naftë prodhim i PPE-së (prodhim para ekzistues) dhe PPA-së (pjesë e Albpetrol Sh.a-së), është lidhur dhe është zbatuar, pa marrë në konsideratë detyrimin në total që kompania “██████████”, ka në datën 31.12.2013, detyrim i cili është në 40,964 ton naftë bruto.

Pa likuiduar këtë detyrim që kompania “██████████”, ka ndaj shoqërisë Albpetrol, ██████████ me detyrë Administrator i shoqërisë, ██████████ me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe ██████████ me detyrë Kryespecialist në Drejtorinë e Marrëveshjeve Hidrokarbure, në tejkallim të kompetencës ligjore, marrin iniciativën dhe i kthejnë kësaj kompanie sasinë 11,011 ton naftë bruto.

Marrëveshja e datës 04.04.2014, nuk është nënshkruar nga Drejtoria Juridike, Drejtoria e Shitjes, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Prodhimit, si dhe nuk ka asnjë dokument ose provë tjetër shkresore, ku të jetë shprehur opinioni i tyre për këtë marrëveshje.

Kjo marrëveshje, është kryer duke mos zbatuar paraprakisht proceduat e shqyrtimit dhe miratimit të këtyre ndryshimeve, nga Këshilli Mbikëqyrës, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Këshilli i Ministrave.

Në zbatim të kësaj marrëveshje, Administratori i shoqërisë, me urdhrin nr. 5, datë 07.04.2014, drejtuar Qendrës së Prodhimit të Naftës Ballsh dhe Drejtorisë së Marrëveshjeve dhe Hidrokarbureve, ka urdhëruar shlyerjen e sasisë 11,011 ton naftë bruto, prej të të cilës

deri më 30.06.2014 kompanisë “██████████”, i është kthyer fizikisht sasia 4,184 ton, si njohje e detyrimit nga “Albpetrol” Sh.a. i sasisë 11,011 ton naftë, që ka ndaj kësaj kompanie, prodhim i PPE-së (prodhim para ekzistues) dhe PPA-së (pjesë e Albpetrol Sh.a.-së), për vendburimet Ballsh-Hekal, kthim i cili nuk është bërë nga Qendra e Administrimit dhe Shitjes së Naftës & Gazit Patos, por direkt nga Qendra e Prodhimit të Naftës Ballsh-Hekal, me urdhër të Administratorit ██████████.

Kthim i cili është bërë pa:

- Komision i përbashkët me përfaqësues të kompanisë “██████████” dhe të shoqërisë “Albpetrol” Sh.a., i ngritur me urdhër të Administratorit që do të marrë pjesë për dorëzimin e naftës bruto.
- Faturat teknike të firmosura midis palëve.
- Fletë analiza për çdo faturë teknike.
- Pa përcaktuar pikën e lëvrimit, pikë certifikuar dhe miratuar në AKBN.
- Dokumenti shoqërues administrativ (DSHA)
- Lloji i transportit, për të plotësuar (DSHA).

Sasia e naftës 4,184 ton, nuk është deklaruar në magazinat fiskale, pra për të nuk është prerë dokumenti shoqërues administrativ (DSHA), si dhe nuk është deklaruar në sistem që mbahet në QASHNG, por është dhënë direkt nga Qendra e Prodhimit të Naftës Ballsh-Hekal, duke krijuar në këtë mënyrë mos deklarim të prodhimit të naftës nga kjo kompani, për të shmatur detyrimet fiskale.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, vendimin e KM nr. 612, datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”.

Procedura e ndjekur nga shoqëria “Albpetrol” Sh.a, për kthimin fizik të sasisë 11,011 ton naftë Kompanisë “██████████”, lë shkak për abuzime, të pamundura për tu verifikuar nga grupi i auditimit.

Edhe pse me aktmarrëveshjen e datës 28.02.2014 detyrimi i kompaninë “██████████”, është ulur në vlerën 1,416,443 USD, z. ██████████ me detyrë Administrator i shoqërisë, z. ██████████ me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe z. ██████████ me detyrë Kryespecialist në Drejtorinë e Marrëveshjeve Hidrokarbure, e kanë favorizuar këtë kompani në vlerën 8,233 USD, duke mos i arkëtuar penaltetin për mos likuidim në kohë të faturës nr. 4, datë 28.02.2014 në vlerën 7,200,001 USD që shoqëria “Albpetrol” Sh.a. i ka fatuar kompanisë “██████████” për konvertim.

Marrëveshja e datës 28.02.2014 dhe 04.04.2014 ka dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit dhe ka favorizuar kompaninë “██████████”, çka përbën jo vetëm shkelje të rëndë të legjislacionit në fuqi, por është dhe një shprehje flagrante e mos zbatimit të ligjit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Pezullimin menjëherë të ekzekutimit të shtesë marrëveshjes të kryer nga Administratori i Shoqërisë, për arsye se kjo shtesë e marrëveshjes, nuk është diskutuar paraprakisht nga Këshilli Mbikqyrës, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Këshilli i Ministrave. Ky pezullim duhet të vazhdojë deri në vendimmarrjen përfundimtare nga Këshilli i Ministrave, për arsye se vendimmarrja e Administratorit të shoqërisë Albpetrol për të ndryshuar marrëveshjen është kryer, duke mos zbatuar paraprakisht procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të këtyre ndryshimeve nga Këshilli Mbikqyrës, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Këshilli i Ministrave.

Shoqëria Albpetrol Sh.a. të bëjë llogaritjet e sasisë që ka mbetur dhe t'i kërkojë “██████████”, likuidimin e PPE dhe PPA sipas marrëveshjes bazë.

Çdo ndryshim në mënyrën e shlyerjes të detyrimeve nga “██████████”, duhet të bëhet me miratim nga Këshilli i Ministrave.

Trajtuar më hollësisht në faqet 104-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

Nga auditimi u konstatua se z. ██████████ me detyrë Administrator i shoqërisë “Albpetrol” Sh.a., z. ██████████ me detyrë drejtor i Drejtorisë së Marrëveshjeve dhe Hidrokarbureve dhe z. ██████████ me detyrë K/specialisti juridik i Drejtorisë së Marrëveshjeve dhe Hidrokarbureve, në tejkallim të kompetencës së tyre ligjore, në aktmarrëveshjen e datës 28.02.2014, me kompaninë “██████████”, nuk kanë marrë në konsideratë propozimin e Drejtorisë së Shitjes dhe asaj të Financës për llogaritjen e shpenzimeve të transportit në 3,7 usd/bbl por pa asnjë material provues, kanë vendosur që ky shpenzim të përcaktohej në marrëveshje në vlerën 9 usd/bbl.

Nga kompania “██████████” është lëshuar fatura nr. 5, datë 01.03.2014 sasia 81,125 bbl x 9 usd/bbl = 876,150 usd. Në fakt shpenzimet e transportit për këtë faturë duhet të ishin në vlerën $81,125 \text{ bbl} \times 3.7 = 300,162 \text{ USD} \times 20 \% = 360,194 \text{ USD}$, pra me një diferencë në vlerën 515,956 USD.

Nga kompania “Stream Oil&Gas, Ltd” është lëshuar fatura nr. 11, datë 06.06.2014 sasia 98,640 bbl x 9 usd/bbl = 1,065,322 USD. Në fakt shpenzimet e transportit për këtë faturë duhet të ishin në vlerën $98,640 \text{ bbl} \times 3.7 = 364,968 \text{ USD} \times 20 \% = 437,961$, pra me një diferencë në vlerën 627,361 USD.

Shuma totale e dëmit ekonomik për dy faturat e lëshuara nga kompania “██████████” është në vlerën 1,143,317 USD. Gjithsej është krijuar një efekt financiar negativ me pasojë dëm ekonomik në vlerën 1,143,317 USD.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Në varësi të vendimmarrjes së Këshillit Mbikëqyrës dhe Këshillit të Ministrave në lidhje me marrëveshjen e datës 28.02.2014, të merret në çdo rast në konsideratë rikuperimi i diferencës së rezultuar si pasojë e rritjes së paargumentuar të çmimit të kostos së transportit nga 3,7 në 9 USD/bbl, e cila deri më datë 30.06.2014 (datë në të cilën ka përfunduar dhe auditimi) përlllogaritjet në vlerën 1,143,317 USD, trajtuar më hollësisht në faqet 104-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2014

Nga shoqëria “Albpetrol” Sh.a. Fier nuk është kryer dorëzimi i të gjitha aseteve sipas marrëveshjeve të nënshkruara me kompanitë e huaja. Konkretisht: Nga shoqëria “Albpetrol” Sh.a. Patos nuk është kryer plotësisht dorëzimi i vendburimit Ballsh-Hekal, deri më 30.06.2014 janë dorëzuar 23 nga 112, magjistralet Delvinë-Ballsh, Gorisht-Klos-Usojë, rrjeti i grumbullimit të gazit në vendburimin Cakran-Mollaj, si dhe rrjetet e furnizimit me energji elektrike të vendburimeve Cakran-Mollaj dhe Ballsh-Hekal, duke qenë se kjo shoqëri ka qenë në proces privatizimi dhe asetet e padorëzuara kompanisë, janë futur në data-room-in e përgatitur nga shoqëria konsulente.

Organika e personelit të Drejtorisë së Marrëveshjeve dhe Hidrokarbureve, është në përpjesëtim të zhdrejtë me administratën e shoqërisë “Albpetrol” Sh.a. dhe me rezultatet e arritura. Konkretisht nga 150 punonjës që është personeli i administratës, 63 i ka Drejtorja e Marrëveshjeve dhe Hidrokarbureve.

Për vitin 2013 është programuar PPE dhe PPA në sasinë 105,376 ton (naftë bruto + kontesatë), detyrimi në fakt 104,635.35 ton.

Për 6 mujorin e parë për vitin 2014 programuar PPE dhe PPA në sasinë 48,809 ton (naftë bruto + kontesatë), detyrimi në fakt 49,585 ton.

Më datën 30.04.2013 detyrimi i kompanive të huaja që operojnë në bazë të Marrëveshjeve Hidrokarbureve i prodhimit paraekzistues (PPE) dhe pjesën e “Albpetrol” Sh.a. (PPA), i kanë shoqërisë “Albpetrol” është në vlerën 13,765,427 USD dhe 252,409,080 lekë, kundravlerë e sasisë 30,712 ton naftë bruto dhe kontesatë dhe e sasisë 7,211,688 MNm³ gaz, me një personel me 10 punonjës, ndërsa në 6-mujorin e parë 2014, personeli arriti në 63 persona,

Më datën 31.12.2013 detyrimi është 67,682,57 ton, e konvertuar në lekë është në vlerën 2,930,369,851.50 lekë dhe gaz 8,687,800 Nm³ e konvertuar 304,072,922 lekë, ndërsa më datën 30.06.2014 detyrimi është 55,118.07 ton, e konvertuar në lekë është në vlerën 2,502,342,646.70 lekë dhe 9,815,179 Nm³ vlerë në vlerën 343,531,264 lekë.

Pra, nga sa u përshkrua më sipër, efektiviteti i punës së drejtorisë së marrëveshjeve dhe hidrokarbureve është ulur, dhe organika është 6-fishuar.

Disa nga punonjësit e Drejtorisë së Marrëveshjeve dhe Hidrokarbureve dhe në veçanti nga të Sektorit të Supervizimit, janë pa profesionet përkatës, si inxhinier ndërtimi, inxhinier tekstili, inxhinier mekanik, punonjës të padiplomuar, ose të diplomuar vetëm me sistemin Bachelor etj.

Drejtoria e Marrëveshjeve dhe Hidrokarbureve ka në përbërjen e saj sektorin ekonomik, sektorin juridik, sektorin teknik dhe sektorë të tjerë, duke krijuar në këtë mënyrë struktura paralele me organikën e shoqërisë Albpetrol, e konkretisht me drejtorinë juridike, drejtorinë e financës, drejtorin e prodhimit etj, duke e zbehur në këtë mënyrë veprimtarinë e këtyre drejtorive në përmbushje të detyrimeve të rregullores së brendshme. Këto sektor të drejtorisë së hidrokarbureve e kryejnë veprimtarinë e tyre pa u mbështetur në detyrat konkrete të rregullores së brendshme, pasi ato nuk janë të përfshira, si strukturë në rregullore. Në këtë mënyrë Drejtoria e marrëveshjeve ka venitur organizimin dhe funksionimin e drejtorive të tjera, duke krijuar në këtë mënyrë një shoqëri tjetër paralele me shoqërinë Albpetrol Sh.a. Kjo vërtetohet me marrëveshjen e datës 28.02.2014 për vendosjen e çmimit për BBL të naftë bruto, marrëveshjen e datës 04.04.2014, ku nuk ka firmosur Drejtoria juridike, Drejtoria e shitje, e financës, programimit, si dhe zbatimin e kësaj marrëveshje duke shmangur QASHNG, me mos miratimin e programeve vjetore dhe të buxhetet të kompanive konçensionare nga Këshilli Mbikëqyrës, mos kryerjen e auditimit nga Drejtoria e auditit në kompanitë konçensionare, por nga Drejtoria e hidrokarbure, mos kryerjen rakordimeve midis Drejtorive, si ajo e Marrëveshjeve dhe Hidrokarbureve, Drejtorisë së Prodhimit, të Financës dhe të Programimit, për PPE dhe PPA që kompanitë konçensionare kanë ndaj shoqërisë Albpetrol, mos pasje në dispozicion drejtorive të tjera dokumentacionin e nevojshëm të zbatimit të marrëveshjeve konçensionare, dokumentacion i përgjithshëm (marrëveshjet dhe licencë marrëveshjet), si dhe dokumentacionin bazë të llogaritjeve PPE dhe PPA (raportet mujore, 3-mujore, etj).

Nuk ka akt-rakordime 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore midis Drejtorive, si ajo e Marrëveshjeve dhe Hidrokarbureve, Drejtorisë së Prodhimit, të Financës dhe të Programimit, për dorëzimin e PPE-ve dhe PPA-ve nga kompanitë konçensionare.

Programet vjetore dhe të buxhetet të kompanive konçensionare, nuk janë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Për vitin 2014, janë miratuar programet vjetore dhe buxhetet e shoqërive “[REDACTED]” (katër vendburime) dhe “[REDACTED]” (Visoka), “[REDACTED]” dhe “[REDACTED]”, nuk janë miratuar, ndërkohë “[REDACTED]” është duke zbatuar

programin e vlerësimit për të 9 vendburimet që zgjat 18 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës (Amonica dhe tek ish-Murrizi).

Programet nuk janë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës në kundërshtim me Rregulloren e miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 1357 prot, datë 22.05.2013.

Nuk ka Marrëveshje me kompanitë koncensionare, për pagesat e magazinimit të naftës së lënë në ruajtje nga shoqëria Albpetrol Sh.a. në venddepozitimet e këtyre kompanive, dhe anasjelltas, si dhe miratimi i tyre nga organet drejtuese.

Për punimet ndërtimore të kryera nga kompanitë koncensionare dhe nga vete shoqëria Albpetrol Sh.a, nuk ka leje zhvillimi të dhënë nga organet kompetente, në kundërshtim me Ligjin nr. 1019, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar, dhe të akteve nënligjore në funksion të tij.

Nuk ka leje mjedisore për vendburimet respektive të kompanive koncensionare, edhe pse është përcaktuar në marrëveshjet përkatëse, në kundërshtim me Ligjin nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar me Ligjin nr. 9890, datë 20.03.2008, Ligjin nr. 8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, VKM nr. 13, datë 31.03.2002 “Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 249, datë 24.04.2003 “Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementëve të lejes mjedisore”.

Drejtoria e Marrëveshjeve dhe Hidrokarbureve, edhe pse ka një personel prej 63 punonjës, nuk ka një rregullore ku të jenë përcaktuar detyrat për secilin nga sektorët dhe për secilin punonjës brenda sektorit, si dhe rregullore të rekrutimit të personelit, ku të jenë përcaktuar kriteret e punësimit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës në përfundim të auditimeve që duhet të zhvillohen nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të Albpetrol sha në Drejtorinë e Marrëveshjeve dhe Hidrokarbureve, të marrë në analizë veprimtarinë e kompanive koncensionare për respektimin e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Marrëveshjet përkatëse, dhe mbi bazën e tyre të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë konkrete.

Nga Këshilli Mbikëqyrës të rishqyrtohet organika e personelit të Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure, në raport me organikën totale të administratës dhe në veçanti për sektorët e dubluar (si juridik, ekonomik, teknik etj), rezultateve të arritura nga kjo drejtori, si dhe të merret vendimi përkatës.

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të hartohet rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure, me detyra të specifikuar për çdo sektor dhe secilin nëpunës.

Trajtuar më hollësisht në faqet 104-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2014

Nga Administratori i shoqërisë të merren masa për kryerjen e akt-rakordime 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore midis Drejtorive si ajo e Marrëveshjeve dhe Hidrokarbureve, Drejtorisë së Prodhimit, të Financës dhe të Programimit, për dorëzimin e PPE-ve dhe PPA-ve nga kompanitë koncensionare.

Nga Administratori i shoqërisë dhe Drejtoria e Programimit, të merren masa që programet vjetore dhe buxhetet e kompanive koncensionare, të miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës.

Trajtuar më hollësisht në faqet 104-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të merren masa për hartimin e tarifave të magazinimit të naftës së lënë në ruajtje nga shoqëria Albpetrol Sh.a. në vend-depozitimet e kompanive konçensionare dhe anasjelltas, si dhe për shërbimet e tjera që shoqëria Albpetrol kryen në kompanitë konçensionare, trajtuar më hollësisht në faqet 104-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2014

Nga Administratori i shoqërisë, të merren masa që punimet ndërtimore të kryera nga kompanitë konçensionare dhe nga vetë shoqëria Albpetrol Sh.a, të jenë të pajisura me leje zhvillimi të dhënë nga organet kompetente, në zbatim të Ligjit nr. 1019, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar, si dhe të akteve nënligjore në funksion të tij.

Nga Administratori i shoqërisë të merren masa që vend-burimet e kompanive konçensionare, të jenë të pajisura me leje mjedisore në zbatim të Ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, i ndryshuar, VKM nr. 13, datë 31.03.2002 “Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 249, datë 24.04.2003 “Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementëve të lejes mjedisore”. Trajtuar më hollësisht në faqet 104-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

Me observacionin nr. 6493/2 prot, datë 11.09.2014, për projekt Raportin e Auditimit, janë trajtuar disa probleme të konstatuara nga shoqëria Albpetrol, në kompaninë “XXXXXXXXXX”. Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion as në periudhën audituese as dhe me observacionet e sjella në fund për Projektraportin e Auditimit, dokumentacion justifikues për të bërë trajtimin e kësaj çështje, për pasojë nuk mund të japi opinion e Tij. Nga ana tjetër, askush nuk e ka penguar Administratorin, të informoj Ministrin e Energjisë dhe Industrisë dhe Këshillin e Ministrave.

Për sa më sipër rekomandojmë:

KLSH-ja vlerëson, informacionin e paraqitur me observacionin me nr. 6943/2 prot, datë 11.09.2014 për projekt Raportin e Auditimit, dhe inkurajon Drejtorinë e Auditimit dhe Administratorin e Shoqërisë, të zbatojë procedurat audituese për problemet e konstatuara, trajtuar më hollësisht në faqet 104-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e tyre, të informoj Këshillin Mbikëqyrës, Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe Këshillin e Ministrave.

13. Nga auditimi i Zbatimi i procedurave të ankandit për shitjen e naftës bruto, kontestës dhe gazit, u konstatua se:

Në QASHNG Patos, në bilancin e naftës bruto për periudhën 01.10-31.12. 2013 rezultoi diferencë, në sasinë 4,938.1 ton naftë bruto me vlerë 92,016,555.40 lekë, dhe për periudhën 01.01-30.06.2014 rezultoi diferencë në sasinë 465.48 ton naftë bruto me vlerë 8,673,754 lekë, me diferencë totale në bilancin e naftës bruto në sasinë 5,403.58 ton naftë bruto me vlerë 100,690,309.4 lekë.

Me faturën nr. 7, datë 13.05.2014 për vlerën 9,341,569.75 lekë shoqëria [REDAKTUAR] sh.a, i ka faturuar shoqërisë “Albpetrol” Sh.a. vlerën 9,341,569.75 lekë, për sasinë 1,093.4 ton avull, për përdorimin e avullit për ngrohjen e naftës në objektin 16/1 pranë Kombinatit të Përpunimit të Thellë të Naftës Ballsh.

Për këtë shërbim nga shoqëria “Albpetrol” Sh.a. ose nga Q.A.SH.N.G Patos, nuk është zhvilluar asnjë procedurë prokurimi, nuk është lidhur asnjë kontratë etj, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Udhëzimin e APP-së nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar. Qendra e Administrimit, Shitjes të Naftës dhe Gazit (QASHNG), është organizuar dhe funksionon në vend depozitimit Visokë, Kuçovë, Zharrëz, Usojë dhe 16/1 Ballsh.

- a) Rezervuarët e magazinimit të naftës nga QASHNG, në vend depozitimet e sipërcituar, janë të pa certifikuar.
- b) Laboratorët e analizave fiziko-kimike të naftës, janë të paliçensuar.
- c) Punonjësit që punojnë në këto laboratorët, nuk kanë arsimimin përkatës.

Për periudhën objekt auditimi nga shoqëria Albpetrol Sh.a. është shitur 742,028 Nm³ gaz. Shitja e gazit është kryer pa procedurë ankandi, në kundërshtim me Ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar me VKM nr. 33, datë 19.01.2011, si dhe akti normativ i KM nr. 2, datë 16.06.2010 në zbatim të Ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet”, i ndryshuar.

Shoqëria është lejuar të vazhdoj tregtimin e gazit natyror pa procedura ankandi me shkresën nr. 4993/4 prot datë 15.08.2013 Të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Për periudhën e gjashtë mujorit të parë 2014 Albpetrol është furnizuar me 256 mijë Nm³ gaz dhe ka shitur 254,998 Nm³ gaz. Gazi është shpërndarë në 18 konsumatorë të cilët kanë kontratë furnizimi, të firmosur nga drejtori i QASHNG me autorizim të Administratorit të [REDAKTUAR]

Shlyerjen e detyrimeve këta konsumatorë e kanë bërë pranë QASHNG në llogarinë bankare.

Për periudhën Gusht 2013-Dhjetor 2013 Albpetrol është furnizuar me gaz në sasinë 495.3 mijë nm³ dhe ka shitur gaz 487.030 mijë Nm³.

Shitja e gazit është kryer pa procedurë ankandi, në kundërshtim me Ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar me VKM nr. 33, datë 19.01.2011, si dhe akti normativ i KM nr. 2, datë 16.06.2010 në zbatim të Ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet”, i ndryshuar.

Edhe pse shitja e gazit është kryer pa procedurë ankandi, dhe në kundërshtim me dispozitën e përmendur më sipër, Shoqëria Albpetrol Sh.a, është lejuar të vazhdojë tregtimin e gazit natyror pa procedura ankandi me shkresën nr. 4993/4 prot datë 15.08.2013 të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Shoqëria “Albpetrol” SH.A. Patos, që tregtimi i gazit të bëhet me procedurë ankandi, në zbatim e përputhje me Ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar me VKM nr. 33, datë 19.01.2011, si dhe akti normativ i KM nr. 2, datë 16.06.2010 në zbatim të Ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet”, i ndryshuar.

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë “Albpetrol” SH.A. Patos, ti kërkojë Ministrin të Energjisë dhe Industrisë, revokimin e shkresës nr. 4993/4 prot datë 15.08.2013 të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, shkresë e cila lejon tregtimin e gazit pa procedurë ankandi, shkresë e cila bie ndesh me Ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar me VKM nr. 33, datë 19.01.2011, si dhe akti normativ i KM nr. 2, datë 16.06.2010 në zbatim të Ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet”, i ndryshuar.

Nga Administratori i Shoqërisë “Albpetrol” SH.A. Patos, të merren masa;

- a. për të çertifikuar vend depozitimet e naftës Visokë, Kuçovë, Zharrëz, Usojë dhe 16/1 Ballsh.
- b. për të licencuar laboratorët e analizave fiziko-kimike të naftës.
- c. Punonjësit që punojnë në laboratorët e analizave fiziko-kimike të naftës, të kenë arsimimin përkatës.

Trajtuar më hollësisht në faqet 148-156, të Raportit Përfundimtar të Auditimit

14. Nga trajtimi i ankesave të bëra nga Sindikata e Nxjerrjes së Naftës Patos, në lidhje me administrimin dhe ristrukturimin e shoqërisë Albpetrol Sh.a.

Përsa i përket problemeve të ngritura nga shoqata e sindikatave, në lidhje me drejtimin e kësaj shoqërie nga Administratori [REDAKTUAR], dhe në veçanti abuzimet me kompanitë konçensionare në fushën e hidrokarbureve, pretendimet e shoqatës konsiderohen të drejta, dhe janë trajtuar nga grupi i auditimit, në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Ndërsa në lidhje me Ristrukturimin e shoqërisë Albpetrol Sh.a, nga auditimi u konstatua se:

Shoqëria Albpetrol sh.a, nuk ka në këtë periudhë një marrëdhënie të zyrtarizuar me sindikatat e punonjësve, si dhe nuk është vlerësuar legjitimiteti i përfaqësuesve të sindikatave.

Konkretisht, gjatë vitit 2009 në Albpetrol Sh.a, është lidhur kontrata kolektive e punës për periudhën 19.03.2009-19.03.2011, midis Albpetrol Sh.a. në cilësinë e punëdhënësit dhe Grupit të Organizatave Sindikale në cilësinë e punëmarrësit.

Me mbarimin e kësaj kontrate në Albpetrol Sh.a. u rilidh kontrata për periudhën 30.05.2011 deri më 30.05.2012 me po të njëjtin grupim sindikal.

Me mbarimin e kësaj kontrate nga ana e Albpetrol Sh.a., janë kryer takime të vazhdueshme me përfaqësues të sindikatave për nënshkrimin e kontratës së re kolektive. Deri më sot nuk është arritur nënshkrimi i kontratës pasi sipas Albpetrol Sh.a., përfaqësuesit e sindikatave nuk plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 163 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Deri më 07.08.2014, datë në të cilën përfundoi auditimi, nuk ekziston as një akt që të ketë shfuqizuar nenin 3, pika 4 të kontratës së datës 30.05.2011, në të cilin thuhet se: “Palët kanë të drejtë të hyjnë në bisedime një muaj para përfundimit të kësaj kontrate për hartimin e kontratës së re, në të kundërt në boshllëkun e krijuar do të zbatohet kjo kontratë”.

Nga shoqëria Albpetrol sh.a, nuk është rivlerësuar struktura e brendshme e shoqërisë dhe për këtë mungon vendim i arsyetuar i Këshillit Mbikëqyrës, që të justifikojë shkaqet e ristrukturimit.

Për periudhën e audituar, struktura organizative e shoqërisë, ka pësuar ndryshime në rritje të numrit mesatar të punonjësve me plus 219 punonjës (nga 1,868 në 2,087 punonjës), me efekt financiar në dëm të buxhetit të shoqërisë deri më 31.07.2014, në vlerën 74,954,502 lekë. Kjo

shtesë është në kundërshtim me VKM nr. 106 datë 01.02.2012 “Për trajtimin e punonjësve që dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit të shoqërisë “Albpetrol” Sh.a. Patos”, Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nr. 12 datë 03.09.2013 “Për zbatimin e VKM nr. 106 datë 01.02.2012 “Për trajtimin e punonjësve që dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a Patos”, si dhe me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 5, datë 13.11.2013 “Për miratimin e strukturës së shoqërisë “Albpetrol” Sh.a”, dhe numrit të punonjësve të shoqërisë për 1,868 punonjës. Kjo shtesë e fuqisë punëtore është e pa justifikuar me rritjen e të ardhurave financiare.

Për periudhën e audituar struktura organizative e shoqërisë ka pësuar ndryshime në rritje të numrit të administratës, me plus 21 punonjës (nga 129 në 150), si dhe janë marrë 30 punonjës administrate me kontratë të përkohshme, me një me efekt financiar në dëm të buxhetit të shoqërisë deri më 31.07.2014 në vlerën 9,974,376 lekë.

Kjo rritje ka ardhur nga rimarrja në punë e punonjësve të tjerë, pa argumentuar nevojën e kësaj shtese, si dhe në kontradiktë me pushimin e punonjësve nga puna.

Nga Administratori i shoqërisë Albpetrol Sh.a, nuk është respektuar procedura e parashikuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, lidhur me rastet e Pushimit kolektiv.

Shoqëria Albpetrol Sh.a., lidhur me rastet e Pushimit kolektiv, nuk ka korrespondencë që të vërtetojë që procedura të jetë ndjekur konform Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, me pjesëmarrjen e Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Për sa trajtuar më lart, kanë sjellë në penalizmin e shoqërisë nga ankimet në Gjykatë, me një vlerë 73,535,189 lekë.

Kontrata kolektive ka parashikuar, të gjitha kushtet e marrjeve në punë dhe zgjidhjeve të kontratave të punës, por vazhdimisht shoqëria ka paguar penalitete për shkak të vendimeve të Gjykatave, që kanë dalë si pasoje e disa zgjidhjeve të padrejta të kontratave të punonjësve. Pagesat janë si më poshtë:

Nr	Vitet	Vlera
1	2009	1,294,448
2	2010	10,062,213
3	2011	9,277,321
4	2012	24,184,058
5	2013	28,717,149
	Shuma	73,535,189

Gjithashtu sipas kontratës kolektive janë parashikuar përfitime për punëmarrësit në raste sëmundjesh apo fatkeqësish, duke filluar nga 50,000 deri në 400,000 lekë. Në kushtet aktuale, shoqëria paguan për të njëjtat raste shumat nga 30,000 deri në një pagë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Në vlerësim të ankesave të bërë në KLSH dhe institucionet më të larta shtetërore nga shoqata e sindikatave të Shoqërisë “Albpetrol”, Sh.a, duke e vlerësuar rëndësinë e çështjeve të

ngritura në to dhe duke i konsideruar ato si të drejta, nisur nga fakti që këto çështje dhe të tjera që trajtohen në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, shtrojnë nevojën e shqyrtimit dhe të vlerësimit nga vetë Kuvendi, rekomandojmë:

- a) Ngritjen e një komisioni të posaçëm parlamentar, për analizimin e veprimtarisë dhe situatës së krijuar ndër vite në shoqërinë “Albpetrol” Sh.a Patos, në veçanti për punësimet, largimet nga puna, mosrespektimin e ligjit dhe kontratave të punës, etj., si dhe zgjidhjen e problemeve të akumuluarra përse i përket keqmenaxhimit dhe ristrukturimit të kësaj shoqërie në raport me punonjësit e Albpetrolit ndër vite të përfaqësuar nga Sindikata e Punonjësve;
- b) Drejtuesit e shoqërisë Albpetrol sha, të analizojnë dhe zbatojnë kërkesat e drejta të sindikatës në respekt të zbatimit të marrëveshjes së 2011 me sindikatat, proces i cili duhet të ndiqet dhe mbikëqyret në vazhdimësi nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

Përse trajtuar më sipër dhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH për shoqërinë “Albpetrol” S.H.A., në kushtet kur nga auditimet tona konstatojmë vazhdimësi në keqadministrimin e kësaj shoqërie, mosfunksionim sic duhet të sistemit financiar dhe kontrollit dhe në veçanti të anashkalimit të auditit të brendshëm çka ka sjellë si pasojë mosfunksionimin e kontrollit të plotë të Këshillit Mbikëqyrës ndaj veprimtarisë së administratës së shoqërisë, rekomandojmë që Ministria e Energjisë dhe Industrisë të krijojë një grup të përbashkët auditimi me AKBN për të thelluar dhe shtrirë auditimin në të gjithë aktivitetin e kësaj shoqërie.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga auditimi u konstatua se nga shoqëria “██████████” nuk është shlyer detyrimi që ka ndaj shoqërisë Albpetrol Sh. A. në vlerën 9,052,556.13 USD dhe penalitetet 642,859.57 USD, deri më datën 07.08.2014 (datë në të cilën ka përfunduar auditimi), si dhe nga Avokatura e Shtetit nuk është bërë kërkesë padi për vjeljen e këtij detyrimi. Shoqëria Albpetrol Sh.a., ja ka deleguar këtë kompetencë për efekt të mos pagimit të taksës së sigurimit të kërkesë padisë Avokaturës së Shtetit, delegim që Avokatura e Shtetit e ka pranuar.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Shoqëria “Albpetrol” S.H.A. Patos, duhet të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe përmbarimore dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës vlerën 9.052.556.13 USD dhe penalitetet në vlerën 642,859.57 USD, nga shoqëria ██████████, trajtuar më hollësisht në faqet 24-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi u konstatua se Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm, nuk ka zbatuar dhe realizuar plotësisht rekomandimet e dërguara nga KLSH-së me shkresën 503/10, datë 06.09.2013. Konkretisht nuk janë ndjekur procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës 3,424,751,771 lekë nga Shoqëria “Armo” Sh.a. Fier.

Deri më datën 07.08.2014 nga shoqëria “Albpetrol” Sh.a. nuk ka bërë kërkesë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për arkëtimin e detyrimit në vlerën 3,424,751,771 lekë,

nga shoqëria “Armo” Sh.a. Fier, si dhe nuk është marrë asnjë procedurë tjetër ligjore për arkëtimin e këtij detyrimi.

Por gjatë shqyrtimit të observacionit të dërguar me nr. 6375/1 prot, datë 14.08.2014 dhe dhe nr. 6493/2 prot, datë 11.09.2014, dhe dokumentacionit shoqërues të tij, është bërë kërkesë padi me nr. 6408, datë 08.08.2014 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, depozituar në këtë gjykatë më datë 11.08.2014 për vlerën 3,424,751,771 lekë, si dhe pagimi i taksës 1 % të kësaj vlere, e cila është paguar më datë 08.08.2014 në Bankën Credins, Dega Fier.

Theksojmë se kjo kërkesë padi është bërë pas një dite, të dorëzimit të procesverbalit të përfaqësuesve të autorizuar të KLSH me nr. 43, datë 07.08.2014, protokolluar në arkivën e kësaj shoqërie me nr. 6375 prot, datë 07.08.2014, të mbajtur me objekt ”Mbi mos zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 503/10 datë 06.09.2013”.

Deri më datën 07.08.2014, datë në të cilën ka përfunduar auditimi nga “Albpetrol” SH.A. Patos, nuk është kryer arkëtimi i vlerës 5,374,448,702 lekë (3,424,751,771 lekë detyrim principal dhe 1,949,696,931 penaltet për kamatë vonesa), nga Shoqëria “Albpetrol” SH.A. Patos.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Shoqëria “Albpetrol” SH.A. Patos, duhet të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe përmbarimore dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, për arkëtimin e vlerës 5,374,448,702 lekë nga Shoqëria “Armo” SH.A. Fier.

Nga auditimi u konstatua se z. [REDAKTUAR] me detyrë Administrator i shoqërisë “Albpetrol” Sh.a., z. [REDAKTUAR] me detyrë drejtor i Drejtorisë së Marrëveshjeve dhe Hidrokarbureve dhe z. [REDAKTUAR] me detyrë K/specialisti juridik i Drejtorisë së Marrëveshjeve dhe Hidrokarbureve, në tejkallim të kompetencës së tyre ligjore, në aktmarrëveshjen e datës 28.02.2014, me kompaninë “[REDAKTUAR]”, nuk kanë marrë në konsideratë propozimin e Drejtorisë së Shitjes dhe asaj të Financës për llogaritjen e shpenzimeve të transportit në 3,7 usd/bbl por pa asnjë material provues, kanë vendosur që ky shpenzim të përcaktohej në marrëveshje në vlerën 9 usd/bbl.

Nga kompania “[REDAKTUAR]” është lëshuar fatura nr. 5, datë 01.03.2014 sasia 81,125 bbl x 9 usd/bbl = 876,150 usd. Në fakt shpenzimet e transportit për këtë faturë duhet të ishin në vlerën 81,125 bbl x 3.7 = 300,162 USD x 20 % = 360,194 USD, pra me një diferencë në vlerën 515,956 USD.

Nga kompania “Stream Oil&Gas, Ltd” është lëshuar fatura nr. 11, datë 06.06.2014 sasia 98,640 bbl x 9 usd/bbl = 1,065,322 USD. Në fakt shpenzimet e transportit për këtë faturë duhet të ishin në vlerën 98,640 bbl x 3.7 = 364,968 USD x 20 % = 437,961, pra me një diferencë në vlerën 627,361 USD.

Shuma totale e dëmit ekonomik vetëm për dy faturat e lëshuara nga kompania “[REDAKTUAR]” është në vlerën 1,143,317 USD. Gjithsej është krijuar një efekt financiar negativ me pasojë dëm ekonomik në vlerën 1,143,317 USD.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Në varësi të vendimmarrjes së Këshillit Mbikëqyrës dhe Këshillit të Ministrave në lidhje me marrëveshjen e datës 28.02.2014, të merret në çdo rast në konsideratë rikuperimi i diferencës së rezultuar si pasojë e rritjes së paargumentuar të çmimit të kostos së transportit nga 3,7 në 9 USD/bbl, e cila deri më datë 30.06.2014 (datë në të cilën ka përfunduar dhe auditimi)

përlllogaritet në vlerën 1,143,317 USD, trajtuar më hollësisht në faqet 104-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Kjo shumë të kërkohet duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për rikuperimin e saj.

Brenda datës 31.12.2014

Nga auditimi u konstatua se me faturën nr. 4, datë 28.02.2014 që shoqëria “Albpetrol” Sh.a. i faturon kompanisë “██████████” është 81,125 bbl x 73,96 usd/bl =7,200,001 USD. Në fakt duhet të ishte llogaritur sipas Brendit të publikuar në Platts European Marketscan, në datën 28.2.2014.

Me faturën nr. 29, datë 06.06.2014 që shoqëria “Albpetrol” Sh.a. i faturon kompanisë “██████████” është 98,640 bbl x 73,96 usd/bbl =8,754,580 usd. Në fakt duhet të ishte llogaritur sipas Brendit të publikuar në Platts European Marketscan, në datën 06.06.2014.

Deri më datën 30.07.2014 kjo kompani ka likuiduar vlerë 5,900,000 USD, duke ngelur pa likuiduar 10,054,580 USD. Faturuar 7,200,001+8,754,580 =15,954,581 USD-5,900,00 USD =10,054,580 USD).

Në mbështetje të pikës 19 të marrëveshjes datë 28.02.2014 e cila citon se “██████████”, do të kryejë pagesën e shumës së faturuar brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e lëshimit të secilës faturë. Për çdo vonesë, “██████████” do të paguajë kamatëvonesë për pjesën e papaguar të shumës, sipas normës bazë të interesit të deklaruar nga Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë”, për diferencën 1,300,001 USD (7,200,001 USD-5,900,000 USD), duhet të ishte llogaritur penalteti.

E përlllogaritur, kjo vlerë është në vlerën 8,233 USD (1,300,000 x 3.8 % interes (interesi i Bankës së Shqipërisë) x 60 ditë :360 = 8,233 USD).

Vlera 8,233 USD përbën dëm ekonomik për llogari të shoqërisë “Albpetrol” Sh.a. dhe duhet të dëmshpërblehet nga kompania “██████████”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, proceduriale, përmbartimore si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi në vlerën 8,233 USD, nga kompania “██████████”, trajtuar më hollësisht në faqet 104-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi u konstatua se me vendimin nr. 151 datë 12,03,2014 të Administratorit, është miratuar dhënie shpërblim një pagë mujore (paga neto) gjithsej 533,742 lek, punonjësve ██████████ 103,515 lek, ██████████ 93,510 lek, ██████████ 91,770 lek, ██████████ 82,113 lek, ██████████ 92,553 lek dhe ██████████ 70,281 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 849 datë 06.12.2012 “Për një ndryshim në VKM nr. 929 datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, në mungesë të kontratës kolektive kjo pagesë nuk duhej të bëhej.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimi në vlerën 533,742 lekë, për përfitim të pa drejtë shpërblimi, nga Selman Harizaj 103,515 lekë, Shkëlqim Xhela 93,510 lekë, Ramiz Hoxha 91,770 lekë, Zylfo Mehmeti 82,113 lekë, Faik Bajramaj 92,553 lekë dhe Aranit Hysenaj 70,281 lekë, trajtuar më hollësisht në faqet 34-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi u konstatua se në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje çakulli në sasinë 5,000 m³, u konstatua një diferencë në vlerën 1,863,262.5 lekë, që përfaqëson çakull të pa furnizuar, vlerë e cila përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të zhdëmtohet nga shoqëria Kontraktori “General Beton” shpk.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, procedurale, përmbartimore si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi në vlerën 1,863,262.5 lekë, nga General Beton” shpk, trajtuar më hollësisht në faqet 57-104, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi u konstatua se nga shoqëria Albpetrol Sh.a. është kontraktuar dhe likuiduar “S.C. ABC Trading&Marketing SRL” Rumani, për “Asistencë teknike për auditimin e marrëveshjeve hidrokarbure”, pa zhvilluar asnjë procedurë prokurimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 10, si dhe duke krijuar një dëm ekonomik për llogari të buxhetit të shoqërisë në vlerën 10,000 euro, trajtuar më hollësisht në faqet 50-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 10,000 euro, nga shoqëria “S.C. ABC Trading & Marketing SRL” Rumani, për shkeljet e konstatuara në kontraktimin dhe likuidimin e kontratës me objekt “Asistencë teknike për auditimin e marrëveshjeve hidrokarbure”.

Brenda datës 31.12.2014

Nga auditimi u konstatua se në lidhje me dhënien me qira të Aktiveve afatgjata (objekte e makineri) në 3 raste të dhënies së makinerive me qira, (me vlerë fillestare kontabël prej 16,087,250 lekë) nuk janë kthyer pas përfundimit të kontratës dhe nuk është bërë likuidimi i detyrimeve kontraktuale në vlerën 235,201 lekë. Në 4 raste të dhënies së ndërtesave me qira, të cilat u ka mbaruar afati i kontratave, nuk janë liruar dhe vazhdojnë të shfrytëzohen nga ish-kontraktuesit, të cilët kanë detyrime kontraktuale të pa likuiduara në vlerën 808,658 lekë.

Përsa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, procedurale, përmbartimore si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi në vlerën 1,043,859 lekë, nga subjektet Bujar Gega në shumën 115,200 lekë, Ujësjetllësi Patos në shumën 120,000 lekë dhe nga subjektet qiramarrëse të objekteve Super Link në shumën 587,652 lekë, Alvaro Fiqiriu në shumën 84,150 lekë, Gëzim Myrtaj në shumën 42,280 lekë, Nazmie Leka në shumën 60,376 lekë dhe Pëllumb Rrapaj në shumën 34,200 lekë, trajtuar më hollësisht në faqet 135-140, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

Nga auditimi u konstatua se me vendimin e Administratorit nr. 266 datë 25.04.2014, është vendosur shtesa e tarifës prej 4,000 lekë mbi pagë për punonjësit me arsim të lartë, që punojnë në pozicione pune me arsim të mesëm, të përcaktuar në strukturën organike. Kjo shtesë page nuk është objekt i kontratave individuale të lidhur me punonjësit, pasi në nenin

21, pika 3 gërma (h) të ligjit.nr 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar citon si më poshtë: “Kontrata e punës e lidhur me shkrim duhet të përmbajë sidomos: gërma(h)-elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj”. Si rezultat shpenzimi i kryer për pagesën e shtesës së pagës prej 4,000 lekë në muaj për periudhën prill-qershor të viti 2014 për 32 punonjës është shkelje e kontratës tip individuale neni 19, me pasojë dëmin ekonomik në shumën 302,592 lekë

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi në vlerën 302,592 lekë, përfituar në mënyrë të padrejtë pagë për periudhën prill-qershor të viti 2014 nga 32 punonjës të detajuar sipas aneksit nr. 1 të bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, trajtuar më hollësisht në faqet 34-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

Në vijim të sa më sipër dhe rekomandimeve të KLSH për shpërblim dëmi, mendojmë që dëmi i shkaktuar si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të deritanishme të administratorit të shoqërisë “Albpetrol” SH.A. mund të jetë shumë herë më i madh sesa ai i konstatuar nga KLSH.

Rezultatet e një hetimi të plotë nga Prokuroria dhe konkluzionet e një grupi të përbashkët auditimi ndërmjet Ministrisë dhe AKBN, që KLSH rekomandon të ngrihet për të audituar jo vetëm gjithë aktivitetin e shoqërisë por edhe kompanitë koncensionare (pa cënuar në asnjë rast në rrugë joligjore të drejtat e këtyre kompanive), do të paraqesin realitetin dhe përmasat e vërteta të këtij dëmi, jo vetëm ekonomik..

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, statutit të shoqërisë neni 17 (Për Administratorin), si dhe kontratave individuale të punës, i kërkohet Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit të Shoqërisë, që në varësi të kompetencave të tyre ligjore, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

C/a. “Zgjidhje të kontratës së punësimit” për:

1. [REDAKTUAR] me detyrë Administrator i shoqërisë, për periudhën 30/09/2013 dhe në vazhdim.
2. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Marrëveshjeve – Hidrokarbureve, 23.10.2013 dhe në vazhdim.
3. [REDAKTUAR] me detyrë specialist dhe K/specialist juridik në Drejtorinë e Marrëveshjeve dhe Hidrokarbureve respektivisht për periudhën 28.10.2013-01.12.2013 dhe 02.12.2013 dhe vazhdim.

Për arsye se me veprimet dhe mos veprimet e tyre kanë kryer kthimin nga kompania “[REDAKTUAR]”, të detyrimit të PPE (prodhimit paraekzistues) nga njësi fizike (ton), në kthim në vlerë, me çmim të llogaritur nga vetë “Albpetrol” sh.a., me akt marrëveshjen e datë 28.02.2014 dhe datë 04.04.2014, duke dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit dhe ka favorizuar kompaninë “[REDAKTUAR]”, me vlerë minimalisht të përlllogaritur në 1,416,443 USD.

Veprime këto të kryera në kundërshtim me nenin 1, nenin 3 pika 3.5.1 dhe nenin 26.5 pika 1/6 të Marrëveshjes së Hidrokarbureve, Aktin normativ të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 16.6.2010 "Për një shtesë në Ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)", të ndryshuar, Urdhrit nr. 83 datë 10.2.2012 "Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure", i ndryshuar, Ligjin nr. 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 612, datë 05.09.2012 "Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat".

4. [REDAKTUAR], me detyrë drejtor i QASHNG Patos për periudhën 04.11.2013 e në vazhdim.
5. [REDAKTUAR], me detyrë kryeinxhiner i QASHNG Patos për periudhën 01.11.2013 e në vazhdim.
6. [REDAKTUAR], me detyrë shefe e financës QASHNG Patos për periudhën 01.07.2013 e në vazhdim.

Për arsye se, në Qendrën e Administrimit dhe Shitjes së Naftës dhe Gazit Patos", në bilancin e periudhës 01.10-31.12. 2013, u konstatua diferencë të naftë bruto në sasinë 4,938.1 ton me vlerë 92,016,555.40 lekë, dhe në bilancin e periudhës 01.10.2013-30.06.2014 u konstatua diferencë të naftë bruto në sasinë 465.48 ton me vlerë 8,673,754 lekë.

C/b. "Vëretje me paralajmërim për zgjidhje kontrate", për:

1. [REDAKTUAR], me detyrë përgjegjës i stacionit Usojë për periudhën 02.05.2013 e në vazhdim.
2. [REDAKTUAR], me detyrë përgjegjës i stacionit Visokë periudhën 02.05.2013 e në vazhdim.
3. [REDAKTUAR], me detyrë përgjegjës i sektorit të naftës për periudhën 04.10.2013 e në vazhdim.
4. [REDAKTUAR], me detyrë përgjegjës i stacionit Zharrës për periudhën 23.12.2013 e në vazhdim.
5. [REDAKTUAR], me detyrë përgjegjëse e stacionit Kuçovë për periudhën 10.02.2014 e në vazhdim.

Për arsye se, në Qendrën e Administrimit dhe Shitjes së Naftës dhe Gazit Patos", në bilancin e periudhës 01.10-31.12. 2013, u konstatua diferencë të naftë bruto në sasinë 4,938.1 ton me vlerë 92,016,555.40 lekë, dhe në bilancin e periudhës 01.10.2013-30.06.2014 u konstatua diferencë të naftë bruto në sasinë 465.48 ton me vlerë 8,673,754 lekë.

6. [REDAKTUAR], me detyrë drejtor i drejtorisë së prokurimeve, në cilësinë e specialistit të njësisë së prokurimit.
7. [REDAKTUAR], me detyrë drejtor i drejtorisë së programimit, në cilësinë e specialistit të njësisë së prokurimit.
8. [REDAKTUAR], me detyrë specialist në drejtorinë e prokurimeve, në cilësinë e specialistit të njësisë së prokurimit.
9. [REDAKTUAR], me detyrë specialist në drejtorinë juridike, në cilësinë e specialistit të njësisë së prokurimit.
10. [REDAKTUAR], me detyrë specialist në drejtorinë e prokurimeve, në cilësinë e specialistit të njësisë së prokurimit.

Për arsye se në prokurimin elektronik të tenderit me objekt "Blerje rripa trapezoidal, viti 2013, në prokurimin elektronik të tenderit me objekt "Blerje kabull fuqie", viti 2014, në tenderin me objekt "Blerje rripa trapezoidal", viti 2014 dhe në prokurimin

elektronik të tenderit me objekt “Sigurimi i shëndetit dhe aksidenteve në punë të punonjësve”, nuk kanë patur parasysh në llogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, kërkesat e shkronjës “c”, pika 2, “Llogaritja e vlerës së kontratës”, kreut II-të, rregullat e përgjithshme të priokurimit të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” dhe në kërkesat e veçanta të kualifikimit, për kontratat e mallrave, nuk i është kërkuar operatorëve ekonomik dëshmitë e origjinalitetit të mostrave si dhe dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare të lëshuara nga institucionet e autorizuara që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikime teknike, veprim ky në kundërshtim me gërmën “i”, pika 3, “Informacione të veçanta”, kreu III-të të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik të ndryshuar”.

11. [REDAKTUAR], me detyrë drejtor i drejtorisë së mjedisit, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.
12. [REDAKTUAR], me detyrë drejtor i drejtorisë së burimeve njerëzore, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.
13. [REDAKTUAR], me detyrë drejtor i drejtorisë juridike, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.
14. [REDAKTUAR], me detyrë specialiste në drejtorinë e marketingut, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

Për arsye se në prokurimin elektronik të tenderit me objekt “Sigurimi i shëndetit dhe aksidenteve në punë të punonjësve”, viti 2014, kualifikimi, vlerësimi dhe shpallja e operatorit ekonomik Atlantik sha, si përfaqësues i Bashkimit të operatorëve ekonomik Atlantik sha, Sigal UnicaGroup Austria sha, Insig sha dhe Sicred sha, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

15. [REDAKTUAR], me detyrë drejtor teknik, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.
16. [REDAKTUAR], me detyrë specialiste në drejtorinë e shitjes, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.
17. [REDAKTUAR], me detyrë kryeinxhinier Qendra e transportit Ballsh, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

Për arsye se në prokurimin elektronik të tenderit me objekt “Blerje rripa trapezoidal”, viti 2014, “Blerje Lubrifikantë, viti 2013, kualifikimi, vlerësimi dhe shpallja e operatorit fitues respektivisht, [REDAKTUAR] shpk, dhe [REDAKTUAR] Sh.a, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

18. [REDAKTUAR], me detyrë specialist në Drejtorinë e Prodhimit.
Për arsye se në prokurimin elektronik të tenderit me objekt “Blerje Lubrifikantë, viti 1023, kualifikimi, vlerësimi dhe shpallja e operatorit fitues Alba Oil Sh.a., është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar dhe për periudhën objekt auditimi, është shpenzuar karburant për mjetet e shoqërisë në sasinë 49,060 litra me vlerë 9,699,093 lekë duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, SKK 2 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, duke i krijuar në këtë mënyrë një efekt financiar negativ në vlerën 9,699,093 lekë.

Shënim

Për [REDAKTUAR] të cilët janë ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar, rezultojnë se kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Për këta punonjës nuk është propozuar masë disiplinore, pasi masa

ndaj tyre konsiderohet e ezauruar. Masa e propozuar do të ishte “Zgjidhje të kontratës së punësimit”.

Menjëherë

E. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281 me shkresën nr. 528/28, datë 24.09.2014 është bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier z. [REDAKTUAR] me detyrë Administrator i shoqërisë dhe z. [REDAKTUAR], me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Marrëveshjeve – Hidrokarbureve, z. [REDAKTUAR], me detyrë drejtor i QASHNG Patos për periudhën, z. [REDAKTUAR], me detyrë kryeinxhiner i QASHNG Patos dhe znj. [REDAKTUAR], me detyrë shefe e financës QASHNG Patos.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Fatmir Iliazi, Alfonc Gabili, Irma Shkupi, Thoma Papadhimitri, Vasillaq Peçi, Ramadan Zejnuni dhe Genci Koka më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm znj. Luljeta Nano.